

KETHEA ( Qendër për terapinë e individëve me varësi )

Kethea është rrjeti më i madh i shërbimeve për trajtimin e varësisë nga droga dhe integritet social në Greqi. Kethea përballon përfundimisht varësinë dhe problemet që e shoqërojnë, duke dhënë konsultim dhe terapi kundër varësisë, mbështetje të familjes, kujdes për çështje shëndetësore dhe çështje të pazgjidhura ligjore, arësim dhe instruksion, rikthim në shoqëri dhe në botën e punës.

Të gjitha shërbimet janë falas dhe pa lista pritjeje: në rrugë, në institucionet e dënimit ( burgje), në qendra të ndryshme në të gjithë Greqinë. Gjatë periudhës të terapisë nuk jipen substanca zëvendësuese apo medicamente. Qëllim është abstenimi i plotë dhe konstant nga lëndët droguese dhe rihyrja e individit në mënyrë ekuivalente në shoqëri dhe në botën e punës.

Kethea drejtohet gjithashtu dhe tek të gjithë individët që përballojnë probleme të tjera varësie, si alkoli, kumari dhe interneti. Në të njëjtën kohë, përdor programe parandalimi dhe edukimi shëndetësor dhe përbën një organizëm impulsiv në edukimin dhe kërkimet në fushën e varësive.

**KETHEA MOSAIC:** Një program posaçërisht për emigrantët.

Duke njohur nevojat specifike të njerëzve që përbëjnë shoqërinë multikulturore që jetojmë, Kethea krijoi Kethea – Mosaic, një program që i drejtohet emigrantëve, të cilët përballojnë probleme varësie dhe kanë nevojë të rihyjnë në jetën shoqërore. Programi ofron informim individual, konsultim, mbështetje psikologjike dhe kujdes shëndetësor për emigrantët dhe përgatit ata që dëshirojnë të hyjnë në proces për përbalimin e varësisë psikologjike. Njëkohësisht, mbulon nevoja të përgjithshme të kujdesit social dhe mbështetjes të individëve të varur, nëpërmjet lidhjes me shërbime të tjera, informim juridik, mësim të gjuhës greke, qendër për të rinjtë..

Njohuria e gjuhës greke, nuk përbën presupozim për të hyrë në program, ekziston mundësi përkthimi në gjuhët e individëve që mbështeten. Gjithashtu, shërbime informimi dhe konsultimi mund të pranojnë familjet dhe shokët e emigrantëve me varësi nga substancat.

Po je emigrant dhe përballon probleme varësie mund të drejtohesh në KETHEA MOSAIC:

**KETHEA MOSAIC**

Magnisias 28 & Zoljoti 2

11251, Athinë

Tel. 210 8256944, 210 8257164, 210 8256237

Fax: 210 8257163

[Info@kethea-mosaic.gr](mailto:Info@kethea-mosaic.gr)

Gjithashtu, komuniko me programin në dëshiron të bëhesh «urra lidhëse» midis Kethea Mosaic dhe patriotëve të tu.